

VENDIM
Nr.6, datë 24.1.2007

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në seancën gjyqësore të datës 24.1.2007, morën në shqyrtim çështjen civile me palë:

PADITËSE: QEFISERE DINGU, përfaqësuar nga Av. Ilir Selenica
TË PADITUR: **FATMIR MAÇI, PIRO DODE**, përfaqësuar nga Av. Viktor Ikonimi
PERSON I TRETË: SHOQËRIA “**AL&GI**” **TIRANË**, në mungesë
OBJEKTI I PADISË: Dorëzim pasurie që rrjedh nga trashëgimia. Pavlefshmëri e kontratës së dhurimit, datë 13.11.1997.

Baza ligjore: **Nenet 349 dhe 92 të Kodit Civil.**

Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr.2756, datë 17.6.2003, ka vendosur:

Pranimin e kërkesëpadisë.

Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.1259, datë 9.12.2003 ka vendosur:

Prishjen e vendimit dhe kthimin për rigjykim në atë gjykatë, me arsyetim-shkelje procedurale.

Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr.2843, datë 4.6.2004, ka vendosur:

Rrëzimin e padisë.

Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.514, datë 14.4.2005 ka vendosur:

Lënien në fuqi të vendimit.

Kundër vendimit nr.514, datë 14.4.2005 të Gjykatës së Apelit Tiranë, ka ushtruar rekurs paditësja Qefisere Dingu, duke parashtruar këto shkaqe:

- Gjykata ka gabuar kur ka trajtuar padinë e kërimit të trashëgimisë si një padi të njohjes bashkëpronare, duke parë momentin e kompensimit si një marrëdhënie juridike detyrimi dhe jo pronësie.

- Vendimi i KKP-ve, që kompenson vetëm njërin nga trashëgimtarët, duke veçuar të tjerët, është në kundërshtim me ligjin, pasi kompensimi nuk mund të bëhet vetëm për njërin nga trashëgimtarët, ku prona dhe pjesët përkatëse nuk janë ndarë nga gjykata, e për pasojë trualli prej 1200 m², u takon të gjithë trashëgimtarëve.

Kolegjet e bashkuara të Gjykatës së Lartë, pasi dëgjuan relativimin e çështjes nga gjyqtarët Agron Lamaj dhe Ylvi Myrtja; përfaqësuesin e paditëses, i cili kërkoj pranimin e rekursit; përfaqësuesin e së paditurës, i cili kërkoj rrëzimin e rekursit; dhe pasi shqyrtoi e bisedoi në tërësi çështjen,

VËREJNË: paditësja Qefisere Dingu dhe i padituri Fatmir Maçi janë motër e vëlla dhe trashëgimtarë ligjorë të trashëgimlënësit Myslim Maçi.

Komisioni i Kthimit e Kompensimit të Pronave të rajonit nr.1 të Bashkisë Tiranë, me vendimin nr.1345, datë 30.11.1996, ka njohur pronar babain e tyre Myslim Maçi, ndër të tjera, edhe për një truall të zënë me sipërfaqe 17.980 m², së bashku me vëllezërit e tij Xhelal, Hysen, Maliq e Hasan Maçi, e cila do t'i kompensohej me një nga mënyrat e parashikuara nga neni 16 i ligjit nr.7698, datë 15.4.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve”.

Në zbatim të së drejtës së kompensimit që kishte fituar babai i tij, trashëgimlënësi Myslim Maçi, i padituri Fatmir Maçi i është ridrejtuar KKK Pronave për kompensimin e sipërfaqes së tij **të pandarë** dhe me vendimin nr.114, datë 28.8.1997 i është kompensuar në natyrë një sipërfaqe prej 1200 m². Në pikën nr.2 të vendimit të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave thuhet në mënyrë të shprehur:

- “Ish-pronari Fatmir Myslim Maçi, mbas kompensimit sipas pikës 1 të këtij vendimi, humbet të drejtën e kompensimit të fituar në bazë të vendimit nr.1345, datë 30.11.1996 të atij komisioni për sipërfaqen 1200 m². Nga sipërfaqja 4495 m² (1/4 pjesë e sip. 17.890 m² përshkruar më lart), mbeten 3295 m² (4495-1200=3295), për kompensim të pritshëm trashëgimtarëve të Myslim Maçit. Ndërsa,

nga e gjithë prona e përcaktuar për kompensim (vendimi 1345), mbeten 16.890 m², për të gjithë bashkëpronarët (17.890-1200=16.890)”.

Sipas vendimit të mësipërm të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave mbetej për kompensim të pritishtëm për trashëgimtarët e Myslim Maçi 3295 m² dhe për të gjithë bashkëpronarët (trashëgimtarët), etj., 16.890 m².

Në datën 13.11.1997 i padituri Fatmir Maçi, trullin me sip.1200 m², të marrë me vendimin e mësipërm të KKK Pronave me nr.114, datë 28.8.1997, ia ka dhuruar të paditurit tjetër Piro Dode. Ky i fundit me kontratë sipërmarrje me shoqërinë “AL&GI” ka përfunduar ndërtimin e dy pallateve mbi këtë truall.

Me padinë objekt gjykimi, paditësja Qefsere Dingu ka kërkuar dorëzimin e pasurisë trashëgimore, që mbahet prej të paditurve në mënyrë të paligjshme dhe pavlefshmërinë e kontratës së dhurimit. Kërkimet paditësja i ka mbështetur në nenet 92 dhe 349 të Kodit Civil.

Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr.2756, datë 17.6.2003, ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë së ngritur nga paditësja Qefsere Dingu, detyrimin e të paditurit Fatmir Maçi t’i dorëzojë pasurinë trashëgimore në 1/8 pjesë dhe konstatimin absolutisht të pavlefshëm të veprimit juridik të dhurimit të kryer midis të paditurve, me arsyetimin se:

- “Ky veprim juridik është absolutisht i pavlefshëm, pasi pasuria trull prej 1200 m² që është dhuruar nga Fatmir Maçi nuk është e Fatmir Maçi, por e të gjithë trashëgimtarëve ligjorë të Myslim Maçi, pasi Fatmir Maçi nuk ka qenë pronar i vetëm i kësaj pasurie dhe e ka dhuruar këtë pasuri pa pëlqimin e trashëgimtarëve ligjorë”.

Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.1259, datë 11.12.2003, ka vendosur prishjen e vendimit nr.2756, datë 17.6.2003 të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim për shkelje të rënda të normave procedurale në lidhje me përbërjen e trupit gjykues të parashikuara nga nenet 181/3, 467/b dhe 472/b të Kodit të Procedurës Civile.

Pas rigjykimit, **Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë**, me vendimin nr.2843, datë 4.6.2004, ka vendosur rrëzimin e padisë së ngritur nga paditësja si të pambështetur në ligj, me arsyetimin se:

- Trualli objekt konflikti i është dhënë në pronësi të paditurit Fatmir Maçi në bazë të së drejtës së kompensimit që ai ka pasur. I padituri Fatmir Maçi këtë truall e ka fituar jo sepse ky ka qenë dikur i trashëgimlënësit të tij. I padituri është bërë për herë të parë pronar mbi këtë truall, sepse deri atëherë ka qenë në pronësi të shtetit.

- Në bazë të vendimit nr.114, datë 28.8.1997 të KKK të Pronave, kompensimi është bërë për llogari të Fatmir Maçi dhe jo të trashëgimlënësit të tij Myslim Maçi. Mbi truallin e kthyer për efekt të kompensimit, ish-pronari Myslim Maçi nuk ka pasur ndonjëherë ndonjë të drejtë pronësie.

- Ish-pronari Myslim Maçi nuk kishte si të linte me trashëgim një të drejtë që nuk e kishte pasur ndonjëherë.

- Trualli prej 1200 m², objekt konflikti, asnjëherë nuk ka qenë në pronësi të Myslim Maçi dhe as i është njohur atij më vonë në emrin e tij.

- Paditësja Qefsere Dingu nuk heq nga trashëgimlënësi i saj Myslim Maçi asnjë të drejtë mbi sendin konkret objekt konflikti.

- Duke qenë se nuk gjendet i bazuar kërkimi i parë i padisë, automatikisht rrëzohet edhe kërkimi i dytë, pavlefshmëria absolute e kontratës së dhurimit, pasi është kërkim i ndërruar nga kërkimi i parë.

Kundër vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë ka paraqitur ankim paditësja Qefsere Dingu, e cila ka kërkuar prishjen e vendimit dhe kthimin e çështjes për rigjykim, duke parashtruar se:

- Baza ligjore e kërtimeve të mia të parashtruara në padi për zgjidhjen e konfliktit që kam me palën e paditur janë dispozitat e Kodit Civil dhe jo ligji “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve”.

- Gjykata e ka zgjidhur gabim çështjen, pasi ligji “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve” kthen dhe kompenson vetëm ish-pronarin dhe nuk bën pjesëtim prone për secilin trashëgimtar.

- I padituri ka marrë më shumë se ½ e sipërfaqes që i takon të kompensohen të 8 (tetë) trashëgimtarët e familjes “Maçi”.

Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.514, datë 14.4.2005, ka vendosur lënien në fuqi të

vendimit nr.2843, datë 4.6.2004 të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, me arsyetimin se:

- Me vendimin nr.114, datë 28.8.1997 të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, kompensimi është bërë për llogari të të paditurit Fatmir Maçi dhe jo të trashëgimtarëve të trashëgimlënësit Myslim Maçi.

- Paditësja Qefsere Dingu mbi sipërfaqen e kompensuar nuk ka pasur dhe nuk ka ndonjë të drejtë pronësie.

- Qëndrimi i mbajtur nga Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr.2843, datë 4.6.2004 është ligjor.

- Prona me të cilën është kompensuar në natyrë i padituri Fatmir Maçi nuk bazohet te trashëgimia, por në një marrëdhënie detyrimi që ka shteti për të kompensuar privatën.

- Përsa origjina e pronës e të paditurit Fatmir Maçi nuk rrjedh nga trashëgimia, por e përfituar si kompensim në njërin nga mënyrat që parashikon neni 16 i ligjit nr.7698, datë 15.4.1993, paditësja nuk gëzon të drejtën në kërkimet e saj sipas objektit të padisë.

Kundër vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë dhe Gjykatës së Apelit Tiranë ka ushtruar rekurs paditësja Qefsere Dingu, e cila ka kërkuar prishjen e të dy vendimeve dhe kthimin e çështjes për rigjykim në shkallë të parë, duke parashtruar se gjykatat kanë gabuar në zbatimin e ligjit.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin e datës 13.6.2006, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë për efekt të njësimi të praktikës gjyqësore, duke shtruar për zgjidhje pyetjen: nëse në rastin e kompensimit që i bëhet pronës së zënë të njërit prej bashkëpronarëve do të ndodhemi para pasurisë trashëgimore, d.m.th. trualli që jep shteti nga prona e tij do të quhet se është pasuri trashëgimore, apo do të trajtohet si kompensim (marrëdhënie detyrimi).

Rekursi i paraqitur nga paditësja Qefsere Dingu u mor për shqyrtim nga Kolegjet e Bashkuara më datën 24.01.2007. Mbrojtësi i paditëses pretendoi se trualli me sipërfaqe 1200 m² që i është kthyer vetëm të paditurit është pasuri trashëgimore dhe u takon të gjithë trashëgimtarëve, ndërsa mbrojtësi i të paditurit pretendoi se ai (trualli) nuk është pasuri trashëgimore, dhe se në çështjen objekt gjykimi kemi të bëjmë me një marrëdhënie detyrimi të shtetit me klientin e tij Fatmir Maçi.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë çmojnë se pretendimet e ngritura në rekurs dhe gjatë gjykimit në Gjykatën e Lartë nga paditësja Qefsere Dingu janë të drejta, të bazuara në ligj dhe në prova.

Gjykatat arsyetojnë se i padituri Fatmir Maçi të drejtën e pronësisë mbi truallin objekt konflikti e ka fituar në bazë të së drejtës së kompensimit të sanksionuar në ligjin nr.7698, datë 15.04.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve”. Sipas gjykatave ky kompensim në sipërfaqen prej 1200 m², i vendosur për herë të dytë nga KKK të Pronave për të paditurin Fatmir Maçi është individual dhe e përjashton atë nga çdo lloj kompensimi që do të jepet nga organet shtetërore për të gjithë trashëgimtarët e tjerë të të ndjerit Myslim Maçi.

Arsyetimi i gjykatave është haptazi jologjik dhe zgjidhja e dhënë prej tyre është në kundërshtim me ligjin.

Të drejtën e kompensimit nuk e ka fituar vetëm i padituri Fatmir Maçi, por të gjithë trashëgimtarët, përfshirë edhe paditësen. Paditësja Qefsere Dingu ka kërkuar dorëzimin e pasurisë që rrjedh nga trashëgimia, pasi KKK të Pronave i ka njohur asaj dhe trashëgimtarëve të tjerë të 5 (pesë) ish-pronarëve, Myslim, Xhelal, Hysen, Maliq dhe Hasan Maçi të drejtën e kompensimit për sipërfaqen e truallit të zënë.

Me vendimin nr.1345, datë 30.11.1996 të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, ish-pronarëve (trashëgimlënësve), të trashëgimtares (paditëses) Qefsere Dingu i është njohur e drejta e pronësisë për një pjesë të sipërfaqes dhe kompensimi për pjesën tjetër që nuk mund të kthehej. Paditësja Qefsere Dingu trashëgon në 1/8 pjesë të pasurisë trashëgimore të rrjedhur nga trashëgimlënësi i saj, i ndjeri Myslim Maçi.

Sipas gjykatave, i padituri truallin objekt konflikti gjyqësor e ka fituar jo sepse ky ka qenë dikur i trashëgimlënësit.

Në të kundërtën, trualli objekt konflikti vërtet nuk ka qenë i trashëgimlënësit, por është marrë nga i padituri si trashëgimtar për shkak të kompensimit të sanksionuar në ligjin nr.7698, datë 15.4.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve”.

Kolegjet e Bashkuara çmojnë se pasuria e trashëgimlënësit nuk përfshin vetëm të drejtën e pronësisë mbi sende të caktuara pronë e tij, por edhe tërësinë e të drejtave reale e të detyrimeve që zotëronte apo mbante ai në gjallërinë e tij. Në bazë të nenit 332 të Kodit Civil dhe ligjit nr.7698, datë 15.4.1993, trashëgimtari mund të fitojë të gjithë pasurinë e trashëgimlënësit ose një pjesë të saj, ose vetëm një send të caktuar, apo një të drejtë tjetër pasurore siç mund të jetë e drejta për t'u kompensuar.

Gjykatat e kanë pranuar si të vërtetë faktin, se i padituri është bërë për herë të parë pronar i truallit objekt konflikti.

I padituri Fatmir Maçi nuk është ish-pronar, por trashëgimtar, si edhe vetë paditësja. Të gjithë trashëgimtarëve u është njohur e drejta e pronësisë së trashëgimlënësve të tyre Myslim, Xhelal, Hysen, Maliq dhe Hasan Maçi në sipërfaqen 17.980 m², por atyre nuk u është kthyer kjo pronë (*restitution integrum*), sepse ishte e zënë me ndërtime të tjera. Për këtë shkak, trashëgimtarët e Myslim Maçit, ku futen dhe paditësja së bashku me të paditurin, kanë fituar në masën 1/8 pjesë secili të drejtën e kompensimit, e cila në rast se bëhet e mundur të realizohet pas ushtrimit të saj, u kthen automatikisht ose pronësinë mbi truallin, ose të drejtën e kompensimit të truallit të zënë në njërën nga mënyrat e parashikuara në nenin 16 të ligjit nr.7698, datë 15.4.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve”.

Arsyetimi i bërë nga gjykatat se kompensimi është bërë vetëm për llogari të të paditurit Fatmir Maçi dhe jo për llogari të trashëgimlënësit Myslim Maçi është sa i gabuar, aq dhe në kundërshtim me ligjin për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve.

E drejta e kompensimit, e parashikuar në nenin 16 të ligjit nr.7698, datë 15.4.1993, është një e drejtë e mundshme për t'u realizuar në potencë nga të gjithë trashëgimtarët. E drejta e kompensimit është një e drejtë e fituar që me daljen e vendimit nr.1345, datë 30.11.1996 të KKK të Pronave, sepse përbën marrjen përsipër nga shteti të një detyrimi të përcaktuar me ligj, siç është kompensimi, për ta realizuar atë në një kohë të ardhshme në favor të ish-pronarëve apo trashëgimtarëve të tyre.

Në çështjen objekt gjykimi kjo e drejtë ka kaluar në favor të trashëgimlënësve Myslim, Xhelal, Hysen, Maliq dhe Hasan Maçi (neni 1 i vendimit nr.1345, datë 30.11.1996 KKK të Pronave). Paditësja Qefsere Dingu dhe i padituri Fatmir Maçi janë trashëgimtarë të njërit prej ish-pronarëve dhe konkretisht të të ndjerit Myslim Maçi.

Me padinë objekt gjykimi paditësja Qefsere Dingu ka kërkuar të drejtat e tjera pasurore të fituara në mënyrë të prejardhur nga e drejta e pronësisë së trashëgimlënësit të saj Myslim Maçi, të njohura nga shteti me vendimin nr.1345, datë 30.11.1996 të KKK të Pronave dhe të mohuara nga i padituri Fatmir Maçi.

Më konkretisht, paditësja ka kërkuar pjesën e saj në të drejtën e kompensimit për truallin e zënë. Padia për kërkimin e trashëgimit e ngritur nga paditësja është një mjet mbrojtjeje i pasurisë trashëgimore. Këtë padi mund ta ngrenë të gjithë ata trashëgimtarë ligjorë apo testamentarë që thirren në trashëgim, që iu mohohet kjo cilësi nga të paditurit që janë posedues të paligjshëm të pasurisë trashëgimore.

Padia, si një mjet procedural mbrojtjeje i të drejtave subjektive të shkelura dhe i marrëdhënieve juridike-civile, është një institut i së drejtës procedurale civile, që gjen rregullim në dispozitat e Kodit të Procedurës Civile (neni 32).

Gjykatat kanë pranuar se kompensimi është bërë vetëm për llogari të të paditurit Fatmir Maçi dhe jo të trashëgimlënësit të tij, në një kohë që pronar legjitim ishte ky i fundit.

E drejta e kompensimit e ish-pronarit ose e trashëgimtarëve është një e drejtë e njohur me ligjin nr.7698, datë 15.4.1993. Kjo e drejtë, d.m.th. e drejta e pretenduar nga paditësja, buron nga e drejta e pronësisë së ish-pronarit dhe lind për shkak të pamundësisë së kthimit (restitutionit) të pronës që i është marrë pa të drejtë nga shteti. Është e vërtetë se mbi truallin (objekt konflikti) që i është kthyer të paditurit në cilësinë e trashëgimtarit, ish-pronari Myslim Maçi (trashëgimlënësi) nuk ka pasur të drejta pronësie, por kjo pasuri ka lidhje me të drejtën e tij të pronësisë që nuk mund të kthehet për shkaqe objektive, d.m.th. është pasuri trashëgimore dhe shkon në favor të bashkëtrashëgimtarëve sipas pjesëve takuese.

Kompensimi që bëhet në bazë të ligjit nr.7698, datë 15.4.1993 është një kompensim ekzekutiv e detyrues në favor të ish-pronarëve ose trashëgimtarëve të tyre. Kur ish-pronari vdes pasuria e fituar prej tij me kompensim bëhet pasuri trashëgimore dhe shkon në favor të të gjithë trashëgimtarëve sipas pjesëve takuese. Edhe në çështjen objekt gjykimi, e drejta e kompensimit dhe realizimi i saj ka lindur dhe është bërë pas vdekjes së ish-pronarit Myslim Maçi.

I gabuar dhe në kundërshtim me ligjin është edhe arsyetimi i bërë nga gjykatat, se paditësja Qefsere Dingu nuk heq nga trashëgimlënësi Myslim Maçi asnjë të drejtë mbi truallin objekt konflikti.

Në këtë përfundim u arrit pasi paditësja dhe i padituri janë motër e vëlla dhe kanë fituar me titull të prejardhur disa të drejta me trashëgim, si pasojë e vdekjes së trashëgimlënësit të tyre Myslim Maçi. Dihet se fitimi i të drejtave me trashëgim bëhet sipas kushteve të parashikuara në dispozitat e pjesës së tretë të Kodit Civil.

Sipas neneve 316 e vijues të Kodit Civil, trashëgimia është institut i së drejtës civile, që përfshin edhe padinë për kërkimin e trashëgimit. Në këtë kuadër të drejtat që vijnë nga ky institut mbrohen edhe padinë për kërkimin e trashëgimit.

I padituri Fatmir Maçi, në kundërshtim me vendimin nr.1345, datë 30.11.1996 të KKK të Pronave dhe dispozitave ligjore të Kodit Civil mbi trashëgiminë, ka marrë në zotërim truallin objekt konflikti sikur të ishte trashëgimtar i vetëm.

Si paditësja Qefsere Dingu (Maçi) dhe i padituri Fatmir Maçi janë fëmijë të të ndjerit Myslim Maçi, babait të tyre. I padituri Fatmir Maçi e ka marrë këtë pronë në emër të të atit, duke u mohuar trashëgimtarëve të tjerë (8 fëmijëve) të të ndjerit Myslim Maçi të drejtat trashëgimore që ata kanë mbi të. Me të drejtë paditësja pretendon se i padituri ka shtënë në dorë të gjithë pasurinë që vinte trashëgim nga babai i tyre dhe u takonte të gjithë trashëgimtarëve.

Shteti shqiptar kishte detyrimin që t'i kthente pasurinë jo vetëm të paditurit, por gjithë trashëgimtarëve të trashëgimlënësit ish-pronar Myslim Maçi. Kurse në rastin konkret vetëm i padituri Fatmir Maçi ka përfituar si trashëgimtar me kompensim 1200 m² truall nga pasuria që do t'i takonte të ndjerit Myslim Maçi (trashëgimtarëve të tij).

Në këtë kontekst i padituri nuk ka marrë vetëm pjesën e tij, por ka marrë edhe pjesët e trashëgimtarëve të tjerë. Prandaj e drejta e paditëses për të kërkuar pasurinë trashëgimore është një e drejtë e njohur nga ligji. Pretendimi i ngritur nga ajo mbështetet në nenet 350 e vijues të Kodit Civil (neni 32 i Kodit të Procedurës Civile).

Të drejtat e kaluara te trashëgimtarët me vendimin nr.1345, datë 30.11.1996 të KKK të Pronave vërtet nuk janë të përcaktuara përsa i përket volumit të tyre, por gjithsesi këto të drejta janë të përcaktueshme në një kohë të ardhshme me anë të pjesëtimit të trashëgimit.

Në zbatim të nenit 353 të Kodit Civil, cilido nga trashëgimtarët ka të drejtë të kërkojë në çdo kohë pjesëtimin e pasurisë trashëgimore edhe sikur trashëgimlënësi të ketë urdhëruar ndryshe.

Nuk është detyrë e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave të pjesëtoje pasurinë e ish-pronarëve dhe t'ua kthejë atë të gjithë trashëgimtarëve veç e veç.

Vetëm pasi të pjesëtohet pasuria e trashëgimlënësit dhe të formohen pjesët takuese të çdo trashëgimtari (neni 356 i Kodit Civil), këta të fundit mund të hyjnë në marrëdhënie me shtetin për t'u kompensuar veç e veç dhe në pajtim me nenin 16 të ligjit nr.7698, datë 15.4.1993.

Përderisa nuk është pjesëtuar pasuria e fituar me vendimin nr.1345, datë 30.11.1996 të KKK të Pronave, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë arrijnë në konkluzionin se, me vendimin e dytë të KKK të Pronave me nr.114, datë 28.8.1997 që ka kompensuar njërin nga trashëgimtarët (të paditurin), shteti ka përmbushur detyrimin e tij ligjor kundrejt të gjithë debitorëve (trashëgimtarëve), pasi kompensimi nuk mund të bëhet vetëm për njërin nga trashëgimtarët, kur prona dhe pjesët përkatëse nuk janë ndarë nga gjykata.

Meqenëse në këtë rast kompensimi i është bërë njërit prej trashëgimtarëve dhe konkretisht të paditurit Fatmir Maçi, trashëgimtarët e tjerë, ndërmjet të cilëve edhe paditësja Qefsere Dingu, mund t'ia kërkojnë atij pjesën e pasurisë trashëgimore me padinë objekt gjykimi.

Nuk është në kompetencën e KKK të Pronave të caktojë pjesët e trashëgimisë dhe të ndajë pasurinë ndërmjet tyre. Detyra e këtyre komisioneve është përcaktimi i mënyrave dhe masave për kthimin apo kompensimin e pronës së ish-pronarëve apo trashëgimtarëve të tyre (neni 1 i ligjit nr.7698, datë 15.4.1993).

Trualli objekt konflikti me sipërfaqe 1200 m² i dhënë si kompensim i takon të gjithë trashëgimtarëve ligjorë të ish-pronarit dhe jo vetëm njërit prej tyre.

Qëndrimi i mbajtur nga gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e apelit vjen në kundërshtim jo vetëm me konkluzionet e mësipërme të Kolegjeve të Bashkuara, por edhe me vetë bazën juridike të padisë së ngritur nga paditësja Qefsere Dingu. Si gjykata e faktit, ashtu dhe ajo e apelit konkluzionet e tyre i kanë mbështetur në arsyetimin se prona me të cilën është kompensuar në natyrë i padituri Fatmir

Maçi nuk bazohet te trashëgimia, por në një marrëdhënie detyrimi që ka shteti për të kompensuar ish-pronarët ose trashëgimtarët e tyre.

Marrëdhënia juridike e krijuar ndërmjet palëve ndërgjyqëse është ajo e trashëgimisë dhe jo ajo e detyrimit, ku mbështeten gjykatat në arsyetimet e tyre. Marrëdhënia e detyrimit është ndërmjet shtetit (debitor) dhe ish-pronarëve, apo trashëgimtarëve të tyre (kreditor).

Padia për kërkimin e trashëgimit është një e drejtë që kanë trashëgimtarët për të kërkuar para gjykatës njohjen si trashëgimtarë nga të paditurit dhe dorëzimin e pasurisë trashëgimore të cilën ata e posedojnë padrejtësisht, duke u sjellë sikur të ishin trashëgimtarë të vetëm.

Në rastin konkret, gjykatat kanë ngatërruar dy koncepte juridike që kanë të bëjnë me njohjen e pronësisë dhe kompensimin. Këto dy koncepte janë të ndryshme nga njëri-tjetri, pasi në konceptin juridik të njohjes së pronësisë kemi të bëjmë me rregullin juridik të përkatësisë së sendit ndaj një personi, në bazë të së cilës zgjidhet se kujt i përket e drejta e pronësisë. Ndërsa në konceptin juridik të kompensimit kemi të bëjmë me njohjen dhe pranimin e detyrimit të shtetit (debitorit) ndaj personit (kreditorit ish-pronar ose trashëgimtar), për dëmin e shkaktuar (nga shtetëzimi, shpronësimi, konfiskimi apo mënyrave të tjera të padrejta).

Shteti, me vendimin nr.114, datë 28.8.1997 të KKK të Pronave, i ka kaluar të drejtën e pronësisë për efekt të kompensimit (për truallin e zënë) njërit prej trashëgimtarëve dhe konkretisht të paditurit Fatmir Maçi. Me këtë vendim shteti ka përmbushur detyrimin e tij jo vetëm kundrejt njërit prej trashëgimtarëve, por për të gjithë trashëgimtarët ligjorë që heqin të drejta nga trashëgimlënësi Myslim Maçi.

Sa më sipër, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë konkludojnë se marrëdhënia juridike e detyrimit është ndërmjet shtetit dhe trashëgimlënësve Myslim, Xhelal, Hysen, Maliq dhe Hasan Maçi, ose trashëgimtarëve të tyre dhe jo ndërmjet shtetit dhe të paditurit Fatmir Maçi.

Të paditurit Fatmir Maçi të drejtat pasurore mbi truallin me sipërfaqe 1200 m² i burojnë nga trashëgimlënësi i tij Myslim Maçi dhe jo nga shteti.

Kodi i Procedurës Civile ka sanksionuar rregulla të detyrueshme, të njëjta e të barabarta për gjykimin e mosmarrëveshjeve. Objekti i mosmarrëveshjes ndërmjet palëve ndërgjyqëse është përcaktuar nga paditësja. Në këtë kuadër, gjykata ka qenë e detyruar të zgjidhë mosmarrëveshjen në përputhje me dispozitat ligjore dhe normat e tjera në fuqi, që janë të detyrueshme të zbatohen prej saj, duke bërë një cilësim të saktë të fakteve dhe veprimeve që lidhen me mosmarrëveshjen, pa u lidhur me përcaktimin që kanë propozuar palët (neni 16 i Kodit të Procedurës Civile).

E drejta e kompensimit ka si qëllim, në radhë të parë, të mbulojë në një farë mase dëmin që ish-pronari ka pësuar si pasojë e shtetëzimit, shpronësimit, konfiskimit, etj. Në radhë të dytë kompensimi shërben për rivendosjen e së drejtës. Struktura e së drejtës së kompensimit njihet dy forma: si formë **e parë** është kthimi i gjendjes së parë, d.m.th. të marrëdhënies juridike që ekzistonte para shtetëzimit, shpronësimit, konfiskimit, etj. (restitucioni natyral) dhe kur kjo formë nuk është e mundur, aplikohet forma **e dytë**, që bëhet nëpërmjet zëvendësimit të dëmit nëpërmjet kompensimit.

Gjykatat kanë gabuar kur e kanë trajtuar padinë e kërimit të trashëgimisë si një padi për njohjen bashkëpronare. Paditësja ka ngritur padinë objekt gjykimi, mbasi i mohohet cilësia si bashkëtrashëgimtare mbi pasurinë trashëgimore të pandarë, të fituar me vendimet nr.1345, datë 30.11.1996 dhe nr.114, datë 28.8.1997 të KKK të Pronave.

Paditësja, qenien e saj si bashkëpronare me të paditurin Fatmir e pretendon pikërisht në bazë të cilësisë së bashkëtrashëgimtares. Me çeljen e trashëgimisë, pasuria trashëgimore kalon në pronësi të trashëgimtarëve dhe këta trashëgimtarë janë bashkëpronarë në pasurinë trashëgimore. Paditësja ka pretenduar se është trashëgimtare e trashëgimlënësit Myslim Maçi dhe trashëgon bashkë me të paditurin Fatmir pasurinë trashëgimore.

Ajo, d.m.th. paditësja, njohjen si bashkëpronare e pretendon me cilësinë e bashkëtrashëgimtares. Duke qenë padia për kërkimin e trashëgimit një e drejtë e trashëgimtarëve, ajo futet si e tillë në përmbajtjen e marrëdhënies juridike-civile të trashëgimisë.

Ligji për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve kishte si qëllim kthimin e pronës te i zoti duke përfshirë dhe trashëgimtarët, duke rregulluar kështu në masën e mundshme situatën e paligjshmërisë. Ligji në fjalë merr në mbrojtje si ish-pronarët, ashtu edhe trashëgimtarët e tyre. Kjo del në mënyrë të shprehur nga neni 1 i ligjit, në të cilin thuhet: “Ky ligj u njihet ish-pronarëve apo trashëgimtarëve të tyre të drejtën e pronësisë për pronat e shtetëzuara, të shpronësuara apo të konfiskuara”. Për rastet kur kthimi nuk është i mundur, ligji parashikon alternativën e kompensimit.

Mënyra e fitimit të pronësisë nga paditësja dhe i padituri është bërë me titull të prejardhur, meqenëse ka vdekur trashëgimlënësi, nëpërmjet çeljes së trashëgimisë. Në këtë rast sendet dhe të drejtat e tjera pasurore janë transferuar nga pronari te disa pronarë të tjerë, të cilët konsiderohen si fitues të pronësisë me trashëgim. Paditësja, i padituri dhe trashëgimtarë të tjerë që nuk kanë marrë pjesë në këtë gjykim kanë fituar të drejta sipas pjesëve takuese në mënyrë të prejardhur nga e drejta e pronësisë së trashëgimlënësit të tyre.

Trashëgimtarët e ish-pronarit kredinë e tyre ndaj shtetit e kanë të lindur për shkak të së drejtës së kompensimit të pronës që nuk mund t'u kthehet. Nga vendimi nr.1345, datë 30.11.1996 të KKK të Pronave rezulton se paditësja dhe i padituri janë kreditorë solidarë kundrejt shtetit, i cili detyrohej t'u kompensonte atyre dhe të tjerëve trashëgimtarë një sipërfaqe trualli që nuk mund të kthehej.

E thënë më qartë, e drejta e kompensimit është e drejtë e ish-pronarit ose e trashëgimtarëve kundrejt shtetit. Kjo e drejtë paraqitet si e drejtë e personave (pronar ose trashëgimtar) kundrejt detyrimeve shtetërore për një sjellje të caktuar, që përfshin detyrimin për të kthyer pronën (neni 4 i ligjit nr.7698) ose kompensuar atë (neni 16 i ligjit nr.7698), pronën e tyre. E drejta e kompensimit, ndonëse është një e drejtë kredie, prejardhjen dhe bazën e ka në të drejtën reale të pronësisë mbi truallin, që nuk u kthehet ish-pronarëve vetëm për shkakun se nga ligji konsiderohet i zënë.

Në ligjin për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve e drejta e kompensimit është formuluar në mënyrë të tillë kur trojet ose tokat bujqësore të tjetërsuara në truall janë zënë me ndërtime të përhershme, pronarët kompensohen me obligacione, sipërfaqe trojesh ekuivalente dhe mënyrave të tjera të parashikuara nga ligji nr.7698, datë 15.4.1993.

Nga përmbajtja e dispozitës ligjore të cituar më sipër del se detyrimi i marrë përsipër nga shteti kundrejt ish-pronarëve apo trashëgimtarëve të tyre është alternative, sepse mund të bëhet jo vetëm me obligacione shtetërore, por edhe me sipërfaqe trojesh ekuivalente, apo me çdo mënyrë tjetër të parashikuar në ligjin përkatës për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve.

Kur kreditorët janë solidarë si në çështjen objekt gjykimi, secili prej tyre ka të drejtën të kërkojë përmbushjen e të gjithë detyrimit, ose të një pjese të tij dhe në qoftë se përmbushja e detyrimit i bëhet njërit prej tyre (kreditorëve), debitori lirohet ndaj të gjithë kreditorëve (neni 428/2 i Kodit Civil).

Sa më sipër, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë arrijnë në përfundimin se sipërfaqja prej 1200 m² që i është dhënë të paditurit Fatmir Maçi është pasuri trashëgimore dhe u takon të gjithë trashëgimtarëve.

Kjo pasuri të paditurit i ka ardhur me trashëgim nga trashëgimlënësi i tij Myslim Maçi. Shteti nuk ka pasur asnjë detyrim kontraktual, apo ligjor kundrejt të paditurit Fatmir Maçi. Detyrimin ligjor shteti e ka pasur kundrejt trashëgimlënësit ish-pronar, Myslim Maçi. I padituri në fjalë pronën objekt gjykimi e ka fituar me trashëgim si të gjithë trashëgimtarët e tjerë, ndërmjet të cilëve hyn edhe paditësja Qefserë Dingu.

Në këto rrethana, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë çmojnë se duhet të prishen si vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë me nr.514, datë 14.4.2005 dhe vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë me nr.2843, datë 4.6.2004 dhe çështja të dërgohet për t'u rishqyrtuar nga një tjetër trup gjykues në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë.

Konkluzioni se sipërfaqja prej 1200 m² që i është dhënë të paditurit Fatmir Maçi është pasuri trashëgimore dhe u takon të gjithë trashëgimtarëve është i detyrueshëm për trupin gjyqësor që do të rigjykojë çështjen (neni 486 i Kodit të Procedurës Civile).

Nga çështja objekt gjykimi ka dalë se i padituri truallin me sipërfaqe 1200 m², pasuri trashëgimore, e ka tjetërsuar me kontratë dhurimi te kunati i tij Piro Dode dhe ky i fundit me një kontratë sipërmarrje ia ka kaluar shoqërisë "AL&GI" për ndërtimin e disa pallateve.

Nga doktrina juridike është pranuar se edhe në këto raste mund të ngrihet padia për kërkimin e trashëgimit ndaj çdo personi që e ka fituar atë nga një trashëgimtar aparent.

Për këtë shkak paditësja, për të realizuar të drejtën e saj që rrjedh nga e drejta e trashëgimisë, ka thirrur në cilësinë e të paditurit, përveç bashkëtrashëgimtarit Fatmir Maçi, dhe kunatin e tij Piro Dode dhe, në cilësinë e personit të tretë, shoqërinë tregtare "AL&GI".

Legjitimimi pasiv i të tretit është parashikuar shprehimisht në nenin 350 të Kodit Civil. Në këto kushte me të drejtë është ngritur nga paditësja padia për kërkimin e trashëgimit kundër të paditurve dhe kundër personit të tretë që ka përfituar pasurinë trashëgimore me kontratën e

sipërmarrjes. Për këtë arsye, krahas njohjes si trashëgimtar dhe dorëzimit të pasurisë trashëgimore, nga paditësja është kërkuar edhe konstatimi i pavlefshëm i veprimit juridik me të cilin është tjetërsuar pasuria trashëgimore (truall me sipërfaqe 1200 m²) te personi i tretë, shoqëria “AL&GI”.

Meqenëse paditësja (trashëgimtarja) e fiton pronësinë mbi pasurinë trashëgimore që nga koha e çeljes së trashëgimisë, ajo, si pronare e prejardhur e kësaj pasurie, mund ta mbrojë atë mbi bazën juridike të padisë së ngritur. Kjo është arsyeja që ligjvënësi nuk e ka penguar ngritjen e padisë për kërkimin e trashëgimit direkt edhe ndaj personave të tretë.

Në lidhje me kërkimin e dytë mbetet për t’u verifikuar në rigjykim, nëse personi i tretë shoqëria tregtare “AL&GI”, e ka fituar me mirëbesim dhe kundërshtpërbllim pasurinë trashëgimore objekt gjykimi (neni 350/2 i Kodit Civil).

PËR KËTO ARSYE: Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në mbështetje të neneve 481 dhe 485/c të Kodit të Procedurës Civile,

VENDOSËN:

Prishjen e vendimit nr.514, datë 14.4.2005 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe vendimit nr.2843, datë 4.6.2004 të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë, me tjetër trup gjykues.

Ky vendim për unifikimin e praktikës gjyqësore dërgohet për botim në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: K.Ngjela, S.Spiro, P.Zaharia, Y.Myrtja, E.Sinoimeri, B.Imeraj, I.Bala, Sh.Beçaj, G.Dizdari, F.Lulo, A.Dvorani

MENDIM I GJYQTARËVE NË PAKICË

Kemi mendimin se vendimi i gjykatës së apelit duhej lënë në fuqi me arsyetim tjetër.

Nga objekti dhe shkaku i padisë rezulton se paditësja Qefsere Dingu, duke pretenduar bashkëpronësi me të paditurit Fatmir Maçi e Pirro Dode, ka kërkuar dorëzimin e pasurisë trashëgimore e si rrjedhojë, pavlefshmërinë e kontratës së dhurimit të lidhur midis palës së paditur dhe personit të tretë, referuar neneve 349 e 92 të Kodit Civil.

Ashtu sikurse pranohet në gjykimet e mëparshme, por edhe nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, rezulton se palët ndërgjyqëse janë trashëgimtare të babait të tyre, trashëgimtlënësit Myslym Maçi. K.K. Pronave ka njohur pronësinë e ish-pronarit, si dhe të drejtën e kompensimit për një sipërfaqe prej 17.980 m² ish-pronarit, për shkakun se prona ishte e zënë. Më pas njëri prej trashëgimtarëve, i padituri Fatmir Maçi, pjesën e tij në natyrë të pasurisë trashëgimore të njohur me vendimin të K.K. Pronave, ka kërkuar t’i kompensohet fizikisht me një pronë tjetër. Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, ka vendosur t’ia pranojë kërkesën dhe e ka kompensuar me 1200 m² truall, duke përcaktuar njëkohësisht se pjesa tjetër e pronës e mbetur pa kompensuar fizikisht, iu mbetet për t’u kompensuar në të ardhmen bashkëpronarëve të tjerë, duke përjashtuar palën e paditur.

Çështja e shtruar për zgjidhje në gjykatë ka qenë nëse kompensimi i pasurisë sipas ligjit për K.K.Pronave për njërin nga trashëgimtarët e ish pronarit do të konsiderohet si pasuri në bashkëpronësi mes tyre, apo si pronë e vetëm atij për të cilin ka disponuar K.K. Pronave veçmas nga trashëgimtarët e tjerë.

Lidhur me këtë fakt janë mbajtur dy qëndrime në gjykimin e kësaj çështjeje, njëri nga gjykata e shkallës së parë dhe e apelit, të cilat kanë rrëzuar padinë duke mos e konsideruar si pasuri trashëgimore dhe tjetri, ai i Kolegjeve të Bashkuara, që e ka konsideruar të tillë.

Pakica, pa dashur të mbajë qëndrim lidhur me këtë fakt, ka mendimin se mënyra se si është kërkuar e drejta nga pala paditëse, referuar objektit dhe shkakut të padisë, duhej të çonte të gjitha gjykatat në përfundimin se kjo padi duhej rrëzuar. Pala e paditur, me një vendim të K.K. Pronave është bërë pronar i vetëm i sendit të paluajtshëm si kompensim i një pjese të pasurisë që trashëgonte së

bashku me të tjerë, por që për shkak të pamundësisë për t'u kthyer fizikisht, nuk i është kthyer ish-pronarëve. Bashkëpronësia për shkak të trashëgimisë lidhet me sendin që trashëgohet, ndërkohë që ky send nuk i është kthyer trashëgimtarëve të trashëgimlënësit. Në këto kushte, kërkimi i pasurisë trashëgimore, kur nuk bëhet fjalë për një të tillë referuar nenit 349 të Kodit Civil, është një padi që s'mund të ngrihet, pasi sendi që kërkohet nuk është ai i lënë në trashëgim nga *de cujus*. Nga ana tjetër, është i vërtetë fakti që pasuria e paluajtshme e dhënë në kompensim pjesërisht të pasurisë trashëgimore të pakthyeshme për shkak të ligjit, rrjedh nga pasuria trashëgimore. Është ligji ai që parashikon se në rast se pasuria e paluajtshme nuk mund të kthehet fizikisht, ish-pronarit i lind e drejta të kompensohet me një pasuri tjetër të barasvlefshme me të, përfshi dhe pasuri tjetër të paluajtshme. Për këtë, ligji parashikon një procedure të përcaktuar dhe mbi të gjitha vendimmarrje të organit kompetent administrativ, që është Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave. Pra, kërkohet një vendim i këtij të fundit për të kompensuar në natyrë ish-pronarin.

Në këto kushte, mendojmë se është e gabuar padia e ngritur për kërkimin e sendit që rrjedh si kompensim i pasurisë trashëgimore me dispozitën e nenit 349 të Kodit Civil. Sipas këtij neni, trashëgimtari mund të kërkojë me padi nga kushdo që posedon, tërësisht ose pjesërisht, pasurinë trashëgimore që të njihet si trashëgimtar dhe dorëzimin e saj. Në rastin në fjalë, edhe pse pasuria e kompensuar rrjedh nga trashëgimia, ajo nuk është pasuri trashëgimore. Për t'u konsideruar e tillë, padia duhej ngritur kundër vendimit të Komisionit të Kthimit të Pronave dhe palës së paditur duke kërkuar ndryshimin e vendimit të tij si të pabazuar në ligj, për shkakun se organi administrativ ka disponuar të drejtën që ligji njeh për kompensimin e pronës së zënë vetëm në favor të njërit prej trashëgimtarëve. Vetëm me këtë padi mund të bëhet lidhja ndërmjet pasurisë trashëgimore dhe pasurisë së fituar në kompensim të saj për shkak të ligjit.

Në konkluzion, pakica ka mendimin se nuk mund të kërkohet drejtpërdrejt e drejta e njërit prej trashëgimtarëve mbi pasurinë e ardhur si kompensim i pasurisë së trashëguar me nenin 349 të Kodit Civil. Në këto kushte, me këtë objekt dhe shkak padie ajo duhej rrëzuar, për pasojë vendimet e dyja gjykatave duhej të ishin lënë në fuqi me arsyetimin e mësipërm.

Anëtarë: A. Hoxha, Th. Kondi

MENDIMI I PAKICËS

Nuk jemi dakord me vendimin e shumicës për arsyet e mëposhtme:

A. Paditësja pretendon se në rastin konkret është cenuar e drejta e bashkëpronësisë. Pra dalin disa pyetje, të cilave shumica nuk i ka dhënë përgjigje:

1. Cili është kuptimi juridiko-civil i zhdëmtimit?
2. Kuptimi i pasurisë trashëgimore;
3. Natyra juridiko civile e kompensimit;
4. Legjitimiteti i pjesëmarrëseve në proces.

Për sqarimin e këtyre pyetjeve i referohemi nenit 1 të ligjit nr.7698, i cili përcakton:

- së pari: "njohjen e së drejtës së pronësisë për ish-pronarët dhe kthimin e pronës (kur është e mundur, d.m.th. e lirë),

- së dyti: kompensimin.

Pra nëpërmjet këtij ligji, ligjvënësi ka përmirësuar kuptimin e së drejtës së zhdëmtimit, që është detyrimi i shtetit për të marrë përsipër likuidimin e dëmeve të shkaktuara në pasurinë e ish-pronarëve nga veprime të padrejta të organeve të tij.

E drejta e zhdëmtimit nuk ka një karakter të pavarur, ajo është e lidhur dhe është plotësuese e përmbushjes së një detyrimi dhe përgjegjësie që shkaktohet nga shkelja e një marrëdhënie juridike e krijuar mbi bazën e ligjit ose kontratës.

E drejta e zhdëmtimit ka si qëllim, në radhë të parë, të mbulojë në një farë mase **dëmin** që i dëmtuari ka pësuar si pasojë e veprimit të kryer ndaj tij. Në radhë të dytë, zhdëmtimi shërben **për vazhdimin e së drejtës**. Në pretendimin për zhdëmtim kemi të bëjmë me të drejtën subjektive, e cila u dëmtua, por që i kthehet të dëmtuarit në një formë tjetër, duke ruajtur plotësisht vlerën e saj. I tillë është në rastin konkret kthimi i së drejtës së pronësisë dhe i sendit.

Struktura e së drejtës së zhdëmtimit njeh dy forma: e para është kthimi i gjendjes së parë, d.m.th. të marrëdhënies juridike që ekzistonte para shkakimit të dëmit (**restitucioni natyral**) dhe kur

kjo formë nuk është e mundur, kemi zëvendësimin e dëmit nëpërmjet të hollave, ose në formë tjetër që është kompensimi. Pra këto dy forma janë të ndryshme nga njëra-tjetra dhe kanë gjetur pasqyrim edhe në ligjin në fjalë.

E drejta e pronësisë është përcaktuar si e drejtë vetëm e ish-pronarit, që në kushtet e parashikuara në këtë ligj do t'i rikthehet atij.

Lidhur me kompensimin, ligji ka përcaktuar mënyrën e kompensimit dhe masën e tij. Në këtë rast kompensimi nuk njihet dhe përcaktohet si e drejtë vetëm e ish-pronarit, por është një detyrim i shtetit ndaj veprimeve të kryera prej tij që sot, d.m.th. në frymën e ligjit konsiderohen si të gabuara dhe që shkaktojnë dëm. Kështu kompensimi i njihet si ish-pronarit, dhe personave të tjerë (të tretë), kur këto detyrohen t'i kthejnë pronën ish-pronarit.

Pra e drejta e kompensimit është pjesë e dëmshpërblimit që shteti u njeh këtyre subjekteve, por edhe të tjerëve që dëmtohen në pasurinë e tyre. Në këtë kuptim nëpërmjet kompensimit, në kundërshtim me restitucionin natyral, nuk rregullohen marrëdhënie të pronësisë të ish-pronarit me pronën e tij, por detyrimi i shtetit që nëpërmjet një forme të përshtatshme të përmirësojë gjendjen ekonomike të të dëmtuarit.

Pra kompensimi nuk është e drejtë që lidhet me sendin, por me detyrimin ligjor të shtetit për përmbushjen e detyrimit dhe të përgjegjësisë së tij ligjore. Në këtë mënyrë e drejta e kompensimit nuk i nënshtrohet dispozitave mbi pronësinë, trashëgiminë. ose bashkëpronësinë.

Në këto rrethana, të drejtat reale të pjesëmarrësve në poqes u janë njohur vetëm mbi pronën që u është kthyer me vendim të organit kompetent. Pra vetëm nëpërmjet këtij akti, në zbatim të ligjit, është njohur e drejta e pronësisë. Për pjesën tjetër kemi vetëm kompensim, pra zbatim të (marrëdhënies) së detyrimit juridik të shtetit si pasojë e shkakut të dëmit të kryer në pasurinë e pjesëmarrësve në poqes.

Nëse e drejta e kompensimit e shprehur në një formë të caktuar nga organi përkatës është e ligjshme ose jo duhej të bëhej objekt i shqyrtimit gjyqësor, në bazë të dispozitave përkatëse (neni 27 a).

- Trashëgimia është kalimi me ligj ose me testament i pasurisë së personit të vdekur, trashëgimtarëve. Në formën e zhdëmtimit të pasurisë kemi kalim të së drejtës së pronësisë, pra në rastin konkret kemi të bëjmë me zbatim të normave juridike të pronësisë. Në rastin e kompensimit nuk kemi të bëjmë me marrëdhënie reale ose pronësie, por me marrëdhënie detyrimi (shkaktim dëmi), për pasojë nuk mund të gjejë vend zbatimi i së drejtës së pronësisë. Për më tepër në rastin në gjykim, organi përkatës ka kaluar në formën e kompensimit pronën shtetërore. Siç e thamë dhe me lart, nëse ky veprim është i drejtë ose jo nuk është objekt i këtij gjykimi.

Pra përgjigja është se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me pasuri trashëgimore, pasi rrethi i kësaj pasurie është përcaktuar më parë. Shteti, në kuptim të kompensimit, ka përcaktuar disa forma të saj. Si e tillë mund të ishin edhe obligacionet, por në asnjë mënyrë këto obligacione do të ishin në bashkëpronësi të gjithë trashëgimtarëve. Shteti (ligjvënësi) nuk ka pasur si qëllim të rregullojë përkatësinë e sendit pronë e tij kundrejt gjithë pjesëmarrësve në poqes, por vetëm të shpërblejë dëmin që ai i ka shkaktuar këtyre personave.

Paditësja pretendon se pasuria shtetërore e dhënë nga një organ shtetëror kompetent në formën e kompensimit është pasuri e trashëgimlënësit Myslym Maçi.

Kompensimi është realizuar mbi bazën e kërkesës së kërkuarit (të paditurit) drejtuar organit. Është e drejta e organit të zgjedhë një formë të caktuar të dhënies së kompensimit. Por nga ana tjetër ligji ka njohur edhe të drejtën e pjesëmarrësve në proces të ankohen kundër vendimit të komisionit për kthimin dhe kompensimin e pronës, të drejtë të cilën paditësja nuk e ka vënë në përdorim. Ky vendim edhe sot është në fuqi dhe i pacenuar. Gjykata nuk mund t'i japë vetes kompetenca që ligji ia ka deleguar një organi administrativ. Në këto rrethana, gjykoj se paditësja nuk arrin të provojë gjyqësisht pretendimet e saj, për sa kohë vendimi i kompensimit është i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Për këto arsye çmtoj se rekursi nuk duhej të pranohej, pasi vendimi i gjykatës është i drejtë dhe duhet të lihet në fuqi.

Anëtar: A. Lamaj